REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.18, datë 23/05/2005

"PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E NJËSISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK TË QYTETIT NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË APARATIT TË BASHKISË SË TIRANËS"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, gërma ç, ligjit Nr.8549, dt.11/11/1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, ligjit Nr.9131, dt.08/09/2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.5, dt.21/03/2005 "Mbi disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.11, dt.10/03/2004 "Për strukturën organizative të Aparatit të Bashkisë", pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë ngritjen dhe funksionimin e Njësisë së Zhvillimit Ekonomik të qytetit, në strukturën organizative të Aparatit të Bashkisë së Tiranës, sipas tabelës bashkelidhur.

2. Pika 3 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.5, dt.21/03/2005 ndryshon si vijon:

"Numri maksimal i punonjësve të Aparatit të Bashkisë së Tiranës është:
- Punonjës funksionarë dhe nëpunës civilë - 346
- Punonjës me kontratë - 70

3. Efektet financiare të këtij Vendimi fillojnë më datë 01/07/2005 dhe do të mbulohen nga fondet e miratuara për paga dhe sigurime për Aparatin e Bashkisë, në buxhetin e vitit 2005.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI